



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2154/5 Prot.

Vlorë më, 29 . 07 .2026

VENDIM

Nr. 41, datë 29 . 07 2026

**PËR PROPOZIMIN DREJTUAR BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË PAGESËS SË
ORËVE TË MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUARA NGA PERSONELI
AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE, PËR VITIN AKADEMIK 2025–2026**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", si dhe bazuar në relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, përcjellë me shkresën nr. 1718/4 prot., datë 29 .07.2026, Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2026,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e pagesës së orëve të mbingarkesës mësimore, të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, gjatë vitit akademik 2025–2026, sipas relacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të ngarkojë Drejtorinë e Shërbimeve Ndihmëse Akademike dhe Drejtorinë e Shërbimeve Administrative për kryerjen e llogaritjes së orëve të mbingarkesës mësimore dhe të efektit financiar përkatës, në përputhje me aktet në fuqi.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Dr. Aurela Saliaj**

A Saliaj

Konceptoi dhe punoi,
Koordinator i organeve kolegjiale të UV-së, Gilberta Selami

G Selami

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288



Web site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al